

SPECIFIKIME TEKNIKE

‘Raport i specifikimeve Teknike’, si dokument kontraktual, është hartuar nga grupi i punës për objektin “‘Shërbime dhe riparime të dëmeve të shkatuara nga zjarri në zyrat qendrore të UKT sha“

Siguria në punë

Kontraktori duhet të sigurohet se vendi dhe pajisjet janë :

a) Të një tipi dhe standarti të përshtatshëm duke iu referuar vendit dhe llojit të punës që do të kryhet

b) Të siguruar nga një teknik kompetent dhe me eksperiencë

c) Të ruajtura në kushte të mira pune gjatë përdorimit

Gjatë punës të gjithë punëtorët duhet të vishen me veshje të përshtatshme mbrojtëse ose mjete mbrojtëse: helmata, syze, mbrojtëse, mbrojtëse veshësh, dhe bombola frymëmarrjeje.

Cmontim i Dritareve dhe Vetratave Eksituese

Fillimi i punimeve të prishjeve apo largimit të Produkteve Nderimore/ose jo; të ricikliushme ose jo; do të organizohet në mënyrë koherente brenda dhe jashtë godines. Heqja e vetratave dhe dritareve, të cilat do të realizohet para nderhyrjeve në murature.

NDERHYRJE NË RIFINITURAT E BRENDSHME TË OBJEKTIT

Cmontim i Tavaneve Teknike Ekzistuese me Karton-Gips

Cmontim i Pajisjeve / Intalimeve dhe Infrastruktues Ekzistuese: MEKANIKE;

ELEKTRIKE; Cmontim i Pllakave ekzistuese të shtrimit dhe veshjes dhe shtresave të varfra të dyshemese

Cmontim i Dyerve Ekzistuese

Tavane varur gipsi

Përdorimi i kartongipsit kufizohet vetëm në tavanet brenda ndërtesës dhe jo si mure mbajtës. Përdorimi i kartongipsit lejohet kryesisht në ambiente të thata, por rrallë edhe në ambiente me lagështirë. Në rast të përdorimit në ambiente me lagështirë, pllakat e gipskartonit duhet të kenë shenjë të veçantë nga prodhuesi, me të cilën lejohet përdorimi i tyre në ambiente të tilla. Metodat e montimit prej gipskartoni duhet të merren nga prodhuesi. Edhe pse montimi i tyre nuk ndryshon shumë nga njëri - tjetri duhet të zbatohen rregullat e montimit, të cilat i jep dhe për të cilat garanton prodhuesi. Sistemi i mureve prej gipskartoni përbëhet nga këto komponente:

Pllakë prej gipskartoni:

Pllakat në përgjithësi kanë këto dimensione: 62.5 cm x 250 cm dhe 125 cm x 250 cm, kurse trashësia është 12,5 mm ose 15 mm. Për të arritur mure më të mirë për hermetizimin e zhurmave ose kundër zjarrit, munden nga secila anë e murit të vendosen nga dy pllaka njëra sipër tjetrës dhe hapësira ndërmjet dy faqeve të mbushet me material termoizolues dhe bllokues zhurmash. Pllakat duhet të jenë të shenjuara për ambiente të thata apo me lagështirë prej prodhuesit.

Patinim i mureve të brendshme.

Patinimi i sipërfaqeve të mureve të reja të karton xhesit të gjitha llojeve të tyre, realizuar me material të parapergatitur me baze çimento të bardhe dhe pluhur silici, me perzjirje uji

sipas udhezimit qe ka çertifikata e materialit; perfshire skelat e sherbimit dhe çdo detyrim tjetër për të dhënë plotësisht fund procesit.

Tavanet e varura

TAVANET E VARURA Vareset: Vendosen varesë 1200 mm në çdo dhomë ose hapësirë individuale. Në raste se del e nevojshme, vendosen varesë shtesë për të mbështetur kornizat përreth binareve, tubacioneve, kollonave, grilave dhe penetrimeve të tjera në tavan. Në rast se rrjeta e kundërt me të njëjtin kënd është vendosur tek i njëti element mbështetës atëherë mund të vendosen edhe rrjeta të anuara (të pjerreta). Asnjë rrjetë mbajtëse ose asnjë lloj peshe nuk duhet të varet tek ana e poshtme e pjesës metalike.

SHTRESA DYSHEME

Specifikimet e mëposhtme janë emertime baze e të përgjithshme. Bazohen në ligjet dhe normat Shqiptare dhe ato Evropiane : DIN 18352, DIN 18195, DIN EN 186-1, DIN EN 176, ISO177, DIN EN12808, DIN EN 13888 Nuk duhet të fillojë shtrimi i pllakave në rast se temperatura e ambientit nuk është pakten 10°C. Kjo temperaturë ruhet e tillë gjatë gjithë procesit të vendosjes së pllakave por edhe 3 (tre) dite pas përfundimit të procesit. Në rast se ambjentet ku punohet nuk janë teventiluara, atëherë nuk përdoret ngjites.

Gjeometria e shtrimit të pllakave:

Përgjithësisht pllakat shtrohen në drejtime paralele me muret, përveç rasteve kur është përcaktuar ndryshe. Aty ku është e mundur, bashkimet e pllakave të dyshemese duhet të jenë në vazhdim të pllakave të mureve.

Pastrimi

Në çdo dhomë ku ka mbaruar procesi i shtrimit të pllakave, behet një pastrim duke hequr të gjitha mbetjet e llaçit, ngjitesit, çimentos duke përdorur një furçë të ashpër (jo metalike).

Godina do të vishet në të 4(kater) fasadat e jashtme të saj me Struktura/Fasade të ventuiluar.

Fasada e objektit çilesojmë se përpos një tendence dhe afrie estetike, është menduar të respektoje fillimisht **ruajtjen dhe konservimin eficient të energjisë**. Ky aspekt është detyrues dhe përcaktues në zgjedhjen e materialeve në të gjitha nivelet e rifiniturave të jashtme, jo vetëm në veshjen e fasadave të objektit dhe në punimet e maskuara nën to, por edhe në mënyrën e realizimit të mbylljes dhe izolimit të saj në nivelin përfundues të catise, në detajet e kapsulave izoluese të dritareve dhe zgjedhjen e elementeve arkitektonike në vijim.

BOJATISJE

Specifikimet e mëposhtme janë emertime baze e të përgjithshme.

Bazohen në ligjet dhe normat Shqiptare dhe ato Evropiane : **DIN 18363, DIN 18364, DIN 18451, DIN 4102, DIN 6173, DIN EN927-1, DIN 971-1**

Bojrat duhet të jenë paketuar në enë të vullosura në të cilat të demonstron formula e produktit, orientimet e prodhuesit midis të cilave përfshihen edhe paralajmërimet për marrje

masash paraprake,. Lyerjet faqeve te jashtme te godines: Ndalohet realizimi i lyerjes se siperfaqeve ne kushte e motit te papershtateshme si ne rastet me mjergull, me shi ose me diell te forte. **Lyerjet e brendshme:** Behet lyerja vetem kur siperfaqet ne te cilat do te behet lyerja, jane thare mire.

Sistemet e lyerjes duhet te jene te kompletuara para se te filloje puna me qellim qe pompat, mbushesit, rulat, tonerat etj., te cilet rekomandohen per tu perdorur nga prodhuesit te jene ne rregull dhe te plotesojne sistemin e lyerjes.

Kabull In FTP Cat 6

Kabell FTP Cat 6, me shpejtesi transmetimi minimalisht deri ne 10gbps. Te jete i pershtatshem per konektore RJ45.

Pinca Rrjeti

Pinca rrjeti me doreze me gome ergonometrike, te pershtatshme per lidhjen e konektoreve RJ45, RJ 11 dhe RJ 12

Koka Rrjeti FTP 6

Koka rrjeti per kabell FTP Cat 6, sipas RJ45

Fasheta

Fasheta me gjatesi te pakten 150mm dhe gjeresi 3.5mm. Pako me te pakten 100 cope.

Priza internet FTP Cat 6

Priza interneti per kabell FTP Cat 6, te pershtatshme per montim koka rrjeti RJ45 dhe te suportojne shpejtesi minimalisht deri ne 10gbps

Patch panel 24M

Patch panel I pershtatshem per montim ne rack 19" me te pakten 24 porta me lidhje RJ45.

Sëitche 24M

Sëitche me 24 porta per montim ne rack shpejtesia e transmetimit te te dhenave minimalisht 1gbps

Kabuj rryme

Kabujt e rrymes te jene me percjelles bakrri me fleksibilitet min te klasit 5 dhe me mbeshtjellje elastometrike per nje siguri te shtuar ndaj temperaturave te larta. Temperatura maksimale ne qark te shkurtet minimalisht 250°C. tensioni I proves te pakten 3000V.

Priza modulare kanaline.

Te jene te pershtatshme per montim ne kanaline dhe te jene me module per montim.

Kanalina.

Kanalina per kalimin e kabujve me permasa 100x50 dhe 40x25. Ngjyra preferohet e bardhe.

Ndricues led 60x60

Ndricules led katror me permasa 590-600mm, fuqia e ndricimit te pakten 6000lumen dhe drite te bardhe 6400K.

Ndricules hermetik

Ndricules te mbyllur dhe me mbroitje te pakten IP65. Fuqia e ndricimit te pakten 4200lumen. PErmasat maksimale 210x250x80mm.

Kuti shperndarese

Kuti shperndarese per vendosjen e automateve sipas permasave ne preventiv. Te jene te kompletuara bashke me shinen per montim.

Support + kapak 4m

Suport I kompletuar me kapak I pershtashem per 4 module.

Automat 4P 63A

Automat 4 polar per rryme 63 A, ndjeshmeria minimalisht 30mA.

Shkarkues mbitensioni

Shkarkuesi I mbitensionit te jete per rryme minimalisht 32A. kapaciteti ne lidhje te shkurter te pakten 6kA. Jetegjatesia te pakten 10000 cikle.

Zbare 4p

Zbara te jete e pershtatshme per montimin ne kuti shperndarese dhe te jete e pershtashme me shkarkuesit dhe automatet e kerkuar.

Automate

Automate me rrymen sipas kerkeses ne preventive. Kapaciteti ne lidhje te shkurter te pakten 6kA. Jetegjatesia te pakten 20000 cikle.

Xhunto

Xhunto duhet te jet me fileto per te bashkuar tubo ose rakorderi te tjera

Klema

Klemat duhet te jene cilesore per te bere te mundur bashkimin e percjellsave ne menyre sa me te mire

Spina

Spina duhet te kete perdorim te pergjithshem dhe te jete termorezistente dhe lehtesisht e instalueshme

Zgjatues

Zgjatuesi duhet te jete termorezisten ne menyre qe te beje te mundur per te pasur energji ne cdo kend te ambienteve te punes

RL kohe

RL kohe cilesore qe te perdoret per instalimet elektrike

Izolant

Izolanti te perdoret ne cdo instalim elektrik dhe te jete me ngjites

Kondicioner 50 kë

Kondicioneri duhet te jete me fuqi minimalisht 50 kë ne ftohje per nje zgjidhje sa me teper efikafe klasi i energjisë duhet te jete A++ , Lloji i gazit: R410A, dhe Tensioni: 220-230 V

Paisje e brendshme Kasete

Paisje e brendshme e kondicionerit cila do te montohet ne tavan me permasa 60x60 me fuqi nominale ne ftohje minimalisht 3.6 KË Tensioni: 220-230 V

Paisje e brendshme Kasete

Paisje e brendshme e kondicionerit cila do te montohet ne tavan me permasa 90x90 me fuqi nominale ne ftohje minimalisht 7.1 KË Tensioni: 220-230 V

Branxha cu

Branxha bakri duhet te jete me dy dale

Kolektor Cu

Kolektor bakri me 4, 5 dhe 7 me disa dalje

Pulte individuale

Pulte individuale per cdo njesi te brendshme, ne menyre qe cdo njesi te funksionojë ne menyre te pavarur

Tubacione bakri

Tubacione bakri per te bere te mundur lidhjen e njesive te brendshme me elektromotoret me dimensione $\Phi 6.4\text{mm}$, $\Phi 9.5\text{mm}$, $\Phi 12.7\text{mm}$, $\Phi 15.9\text{mm}$, $\Phi 22.2\text{mm}$, $\Phi 28.1\text{mm}$

Tub shkarkimi

Tub shkarkimi per te bere te mundur mbledhjen e ujit te kondesuar nga njesia e brendshme dhe per ta nxjer ne ambiente te jashtme

Kabell komunikimi I skremuar

Kabell I cili ben te mundur komunikimin e pasisjeve mes njera tjetres

Montim-çmontim i pajisjeve ekzistuese, riparimi i tyre

Te behet e mundur riparimi i pajisjeve ekzistuese duke beret e mundur funksionimin e tyre. Rregullim dhe venie ne pune e njesive te jashtme duke i pershtatur me pajisjet e brendshme per sistemin ekzistues

Çmontim i linjave ekzistuese te bakrit

Çmontimi i linjave ekzistuese te cilat jane djegur nga zjarri ne menyre qe te behet e mundur shtrimi i linjave te reja te bakrit.

Vendosje panele fuqie dhe ndricim të katëve

Automat kryesor	60 A	3fazor	cope 2
Diferencial	60A		cope 2
Automat 1 fazor	10A		cope 14
Automat 1 fazor	16A		cope 36
Diferencial	10A		cope 2
Diferencial	16A		cope 2

Zevendesim i panelit të fuqisë për furnizimin e te gjithë pajisjeve te kondicionimit.

Paneli duhet të ketë automat kryesor 400 A (1cope), automat sekondar 250 A (cop 2), automat 32 A (cop 3), diferencial 32 A (cop3).